



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BANKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI MBIKËQYRËS

VENDIM

Nr. 69, datë 13.10.2010

PËR  
MIRATIMIN E TARIFAVE TË PËRDORIMIT TË INFORMACIONIT QË  
MBAHET NË REGJISTRIN E KREDIVE TË BANKËS SË SHQIPËRISË

Në bazë dhe për zbatim të nenit 3, paragrafi 2 dhe nenit 43, shkronja "c" të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar; nenit 127 të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë"; dhe nenit 24 të rregullores "Mbi përmbajtjen e informacionit dhe funksionimin e Regjistrit të Kredive në Bankën e Shqipërisë", me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes dhe të Departamentit të Teknologjisë së Informacionit, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë tarifat e përdorimit të informacionit që mbahet në Regjistrin e Kredive të Bankës së Shqipërisë, sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Këto tarifa janë të zbatueshme me hyrjen në fuqi të rregullores "Mbi përmbajtjen e informacionit dhe funksionimin e Regjistrit të Kredive në Bankën e Shqipërisë" dhe të udhëzimit "Për procedurën e nxjerrjes së Raportit mbi Kredimarrësin dhe rishikimin e të dhënave që mbahen në Regjistrin e Kredive", miratuar përkatësisht nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë me vendimet nr. 67, datë 13.10.2010 dhe nr. 68, datë 13.10.2010.
3. Ngarkohen Departamenti i Mbikëqyrjes, Departamenti i Sistemeve të Pagesave dhe Departamenti i Kontabilitetit dhe Financës me zbatimin e këtij vendimi.
4. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integritimit Evropian dhe Komunikimit për publikimin e këtij vendimi në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

5. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohet vendimi nr. 72, datë 27.11.2007 i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë "Për miratimin e tarifave të përdorimit të informacionit që mbahet në Regjistrin e Kredive të Bankës së Shqipërisë".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI

KRYETARI

YLLI MEMISHA

ARDIAN FULLANI

BANKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI MBIKËQYRËS  
TARIFAT E PËRDORIMIT TË INFORMACIONIT QË MBAHET NË  
REGJISTRIN E KREDIVE TË BANKËS SË SHQIPËRISË

(Miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr.69, datë 13.10.2010)

Komponenti	Përshkrim/detajim	Tarifa në lekë
Tarifa e përdorimit		
Tarifa për kërkim të suksesshëm nga bankat	E pagueshme çdo muaj	100
Tarifa për kërkim të suksesshëm nga subjektet financiare jobanka dhe Unionet e shoqërive të kursim-kreditit	E pagueshme çdo muaj	50
Tarifa për kërkesë nga subjekti i regjistrimit	E pagueshme në momentin e pranimit të kërkesës	500